

## Kushtet për veçoritë InControl Touch Pro dhe Pivi Pro Data e hyrjes në fuqi - 27 shtator 2023

Në këto Kushte, me fjalët "ne/neve/ynë", nënkuptohet Jaguar Land Rover Limited (me numër shoqërie 1672070) me seli në Abbey Road, Whitley, Coventry, CV3 4LF).

### 1. Informacion rreth këtyre Kushteve

Kushtet e përgjithshme të mëposhtme ("**Kushtet**") zbatohen për automjetet e pajisura me funksionet InControl Touch Pro ose Pivi Pro dhe mbulojnë sistemin e informimit dhe argëtimit, shërbimet e lidhura dhe veçoritë e përditësimit të softuerëve (duke përfshirë të gjithë softuerët, imazhet, tekstet, të dhënat dhe përmbajtjet e tjera që janë pjesë ose që lidhen me ato veçori ("**Veçoritë**"). Kini parasysh që jo të gjitha Veçoritë janë të disponueshme në automjetin tuaj pasi kjo varet nga specifikimet e modelit të automjetit dhe të vendit. Kontaktoni shitësin e autorizuar për më shumë detaje.

Mund t'ju kërkohet të pranoni kushte dhe politika të privatësisë shtesë për përdoruesit fundorë kur përdorni Veçori të caktuara, për shembull Veçoritë që ofrohen nëpërmjet ofruesve tanë të zgjedhur palë e tretë, ose që ju mundësojnë të përdorni aplikacione ose përmbajtje në internet (p.sh. shërbimi "Live" i funksionit InControl Touch Pro).

Për funksionin InControl Touch Pro, kushtet e ofruesve palë e tretë zbatohen për shërbimin e navigimit dhe për materialet nga Gracenote. Ju mund t'i lexoni ato në adresat:

- <https://legal.here.com/terms>
- <https://legal.here.com/privacy>
- Referojuni manualit të pronarit të automjetit për kushtet e përdorimit të materialeve nga Gracenote.

Për funksionin Pivi Pro, kushtet e ofruesve palë e tretë zbatohen për navigimin dhe lidhjen e rrjetit celular (duke përfshirë Politikën e Përdorimit të Drejtë). Ju mund t'i lexoni ato në adresat:

- <https://legal.here.com/terms>
- <https://legal.here.com/privacy>
- <https://move.tatacommunications.com/terms-and-conditions>
- <https://move.tatacommunications.com/policies/privacy>

Me përdorimin e Veçorive, ju i pranoni këto Kushte, si dhe kushtet e ofruesve të Veçorive dhe jeni në dijeni të politikave të privatësisë së ofruesve të Veçorive. Lexojini ato me kujdes. **Kushtojini vëmendje të veçantë klauzolave 2 (Kartat SIM dhe tarifat e të dhënave), 7 (Përdorimi i të dhënave dhe privatësia) dhe 8 (Kufizimi i përgjegjësisë) më poshtë.**

Në disa tregje, për të përmbushur kërkesat ligjore vendore, ofruesi i rrjetit celular mund t'ju kërkojë të kryeni një proces verifikimi elektronik të identitetit për të aktivizuar kartën SIM të instaluar nga fabrika.

#### E RËNDËSISHME:

- Ju jeni përgjegjës për t'u siguruar që personat e tjerë që i lejoni të përdorin automjetin të jenë në dijeni të këtyre Kushteve dhe t'i përdorin Veçoritë në përputhje me këto Kushte.
- Këto Kushte zbatohen dhe për ju nëse përdorni një automjet të pajisur me Veçori që është pjesë e një "flote", edhe nëse nuk e keni blerë ose dhënë me qira automjetin personalisht ose nuk jeni abonuar për Veçoritë. Flota është një grup automjetesh që mirëmbahen, zotërohen ose jepen me qira nga një biznes ose organizatë tjetër dhe jo nga një individ ose familje. Për shembull, kjo mund të përfshijë një automjet me qira që ju është dhënë nga një shoqëri makinash me qira, një automjet të vënë në dispozicion nga punëdhënësi juaj ose një automjet të vënë në dispozicion nga ne ose nga shitësit tanë të autorizuar bazuar në një marrëveshje të përkohshme huazimi.
- Këto Kushte zbatohen për çdo akses dhe përdorim të Veçorive, qoftë nëpërmjet kartës SIM të instaluar nga fabrika, kartës SIM të vendosur ose nëse lidheni nëpërmjet Wi-Fi.

Nëse keni pyetje rreth këtyre Kushteve, kontaktoni shitësin e autorizuar.

## 2. Kartat SIM dhe tarifat e të dhënave

- 2.1 Do t'ju duhet një kartë Moduli e Identifikimit të Abonentit (SIM) dhe një plan të dhënash për të përdorur disa Veçori dhe funksione të caktuara (për shembull, lidhjen me Wi-Fi Hotspot, shfletuesin e internetit të InControl Touch Pro dhe shërbimin "Live", nëse është i disponueshëm). Karta SIM në automjet duhet të jetë plotësisht funksionale dhe Veçoritë ose funksionet përkatëse mund të mos funksionojnë nëse karta SIM është dëmtuar, hequr ose instaluar gabimisht.
- 2.2 Karta SIM mund të ofrohet bashkë me automjetin (qoftë e integruar në automjet ose e disponueshme për t'u vendosur në folenë e kartës SIM) ose të blihet dhe e sigurohet nga vetë ju, në varësi të specifikimeve për modelin e automjetit tuaj dhe vendin.
- 2.3 Nëse bashkë me automjetin ju është dhënë dhe një kartë SIM për ta vendosur në folenë e kartës dhe ju zgjidhni ta zëvendësoni atë me një kartë tjetër SIM, ju do të jeni përgjegjës për të gjitha tarifat e të dhënave për përdorimin e kartës tjetër SIM.
- 2.4 Ju jeni përgjegjës për të gjitha tarifat e ofruesit të rrjetit dhe planit të të dhënave në lidhje me kartën tuaj SIM dhe përdorimin e Veçorive (pas çdo periudhe fillestare prove pa pagesë ose planit gjithëpërfshirës të të dhënave, sipas rastit). Këtu mund të përfshihen tarifat e ofruesit të rrjetit për shërbimin ndërkombëtar të të dhënave roaming.

Cilësimet e Lidhjes në automjet ju lejojnë të aktivizoni ose çaktivizoni lidhjen e të dhënave celulare për planin tuaj të të dhënave – kontrolloni këto cilësime nëse dëshironi të shmangni tarifat e shërbimit ndërkombëtar të të dhënave roaming. Ato nuk do të kenë ndikim në përditësimet e softuerit.

- 2.5 Nëse keni përdorur kartën tuaj SIM dhe tani nuk jeni më pronar i automjetit ose nuk e përdorni më atë, ju duhet ta hiqni kartën nga automjeti. Nëse nuk e bëni këtë gjë, do të vazhdoni të jeni përgjegjës për tarifat e të dhënave (nëse ka) për përdorimin e Veçorive në automjet.
- 2.6 Transmetimi i të dhënave nëpërmjet kartës SIM të instaluar nga fabrika bëhet nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacionit celular të cilat ofrohen dhe menaxhohen nga ofruesi ynë i përzgjedhur i shërbimeve të operatorit të rrjetit celular ("Ofruesi i Shërbimit të MNO"), ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ofruesi të licencuar lokalisht me të cilin ofruesi i shërbimit të MNO ka një marrëveshje kontraktuale. Ofruesi i shërbimit të MNO vepron si ofrues i shërbimit të telekomunikacionit për Veçoritë. Do t'ju kërkohet të pranoni termat dhe kushtet e tyre për përdorimin e rrjeteve të telekomunikacionit celular. Për funksionin Pivi Pro kjo nënkupton kushtet e përgjithshme të ofruesit të rrjetit celular në klauzolën 1 më sipër. Për funksionin InControl Touch Pro kjo nënkupton kushtet e përgjithshme të ofruesit të rrjetit, të cilat i pranoni kur regjistroni dhe aktivizoni një kartë SIM në folenë e kartës SIM të automjetit.

### **3. Llogaritë dhe abonimet e përdoruesit**

- 3.1 Për të përdorur disa Veçori dhe funksione të caktuara, së pari do t'ju duhet (a) të konfiguroni një llogari (për shembull, një llogari InControl ose një llogari navigimi Touch Pro) dhe (b) një abonim aktual (abonimi është e drejta për të hyrë dhe përdorur një Veçori të lidhur, për një periudhë të caktuar kohe).
- 3.2 Në momentin që blini një automjet apo paketë opsionesh keni të përfshirë dhe një periudhë fillestare abonimi, në varësi të Veçorisë dhe specifikimeve për modelin e automjetit dhe vendin. Për të vazhduar përdorimin e Veçorisë përkatëse pas periudhës fillestare të abonimit, do t'ju duhet të rinovoni abonimin tuaj dhe të paguani tarifat e zbatueshme të rinovimit. Për më shumë informacion rreth abonimit fillestar dhe mënyrës së rinovimit, mund të kontaktoni shitësin e autorizuar.
- 3.3 Ju jeni përgjegjës për anulimin e llogarisë tuaj në rast se nuk jeni më pronar i automjetit ose nuk e përdorni më atë (për shembull, nëse e shisni automjetin, nëse ju ka përfunduar afati i qirasë ose në rast humbjeje apo vjedhjeje të automjetit). Ju duhet të fshini profilin dhe llogarinë tuaj nga automjeti, të fshini llogarinë dhe të çaktivizoni të dhënat celulare në cilësimet e Lidhjes së automjetit.
- 3.4 Ju jeni përgjegjës për mbajtjen me saktësi dhe të përditësuar të informacionit të llogarisë tuaj, dhe ruajtjen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale të dhënave tuaja të identifikimit. Përveç rasteve kur ne jemi përgjegjës, ne nuk mbajmë përgjegjësi për aksesin dhe përdorimet e paautorizuara të llogarisë suaj ose të Veçorive.

3.5 Pas skadimit të abonimit tuaj, ne mund të fshijmë të gjitha të dhënat që zotërojmë ose kontrollojmë në lidhje me ju, pa pasur përgjegjësi ndaj jush.

#### 4. Përditësimet e softuerit

4.1 Në këto Kushte, "**Përditësimet e softuerit**" janë përditësimet me valë të softuerit për veçoritë InControl Touch Pro, Pivi Pro ose sistemet e tjera të automjetit, të cilat mund të shkarkohen direkt në automjet për të mirëmbajtur ose modifikuar ato sisteme ose për të ofruar veçori dhe kapacitete të përmirësuara për automjetin tuaj.

4.2 Përditësimet e softuerit do të jenë të disponueshme herë pas herë për sistemet e automjetit në rastet kur ai është i lidhur. Ne mund t'ju dërgojmë përditësimet e softuerit ose ju mund t'i kërkonti vetë ato në cilësimet e automjetit.

4.3 Në varësi të llojit të përditësimin të softuerit, specifikimeve të automjetit tuaj dhe kërkesave të tregut vendor, përditësimet e softuerit mund të shkarkohen dhe instalohen automatikisht, ose ju mund të riplanifikoni ose refuzoni përditësimin.

4.4 Kini parasysh kushtet e mëposhtme të rëndësishme për përditësimet e softuerit:

- (a) Në varësi të specifikimeve të automjetit tuaj, përditësimet e softuerit mund të shkarkohen nëpërmjet kartës SIM të integruar në automjet, një karte SIM të vendosur në folenë e kartës ose duke përdorur një lidhje WI-FI. Kini parasysh se përditësimet e softuerit, nëpërmjet një karte SIM që nuk është e integruar në automjet nga fabrika, mund të rezultojë në tarifa për planin tuaj të të dhënave në kartën SIM;
- (b) Gjatë instalimit të disa llojeve të përditësimeve të softuerit, disa funksione dhe shërbime të caktuara të automjetit (për shembull, "Thirrja e emergjencës SOS", "Asistenca e optimizuar në rrugë", alarmi dhe disa veçori të aplikacionit InControl Remote) mund të çaktivizohen përkohësisht. Ju duhet të zgjidhni instalimin e këtyre përditësimeve të softuerit vetëm kur nuk keni nevojë të drejtoni automjetin dhe kur ai është i parkuar në një vend të sigurt;
- (c) Përditësimet e softuerit mund të mos instalohen siç duhet nëse automjeti juaj ka softuerë ose harduerë jo standardë;
- (d) Përditësimet e softuerit do të mbivendosen mbi softuerin aktual në automjet. Kjo mund të zbatohet gjithashtu për çdo softuer jo standard të palëve të treta në automjet;
- (e) Nëse keni pyetje ose hasni probleme në lidhje me përditësimet e softuerit, kontaktoni shitësin e autorizuar.

4.5 Nëse keni një automjet flote, kini parasysh se pronari i flotës mund të ketë kushte të përgjithshme, politika ose procedura që mund të ndikojnë në përdorimin tuaj të përditësimeve të softuerit. Është përgjegjësia juaj të komunikoni me pronarin e flotës së automjeteve rreth përdorimit të përditësimeve të softuerit në automjetin tuaj të flotës.

- 4.6 Për t'ju ofruar përditësime të softuerit, ne mund të mbledhim dhe përpunojmë të dhënat nga automjeti juaj si p.sh. numrin e shasisë dhe informacionin e vendndodhjes. Këto të dhëna do të përdoren përgjithësisht për përcaktimin e disponueshmërisë dhe/ose kualifikueshmërisë për një përditësim softueri në tregun tuaj ose do të detajohen si pjesë e një publikimi.

## **5. Përmbajtjet dhe shërbimet e palëve të treta**

- 5.1 Funkcionet Pivi Pro dhe InControl Touch Pro ju mundësojnë të aksesoni disa përmbajtje dhe shërbime të caktuara të palëve të treta nëpërmjet Veçorive në automjetin tuaj (për shembull, shërbimin "Live" në funksionin InControl Touch Pro). Ne kemi zgjedhur dhe kemi vënë në dispozicion aksesin në këto përmbajtje dhe shërbime të palëve të treta për t'ju ardhur në ndihmë klientëve tanë.
- 5.2 Përmbajtjet dhe shërbimet e palëve të treta ofrohen nga ofruesit tanë të zgjedhur palë e tretë. Përmbajtjet dhe shërbimet e palëve të treta janë subjekt i kushteve të përgjithshme dhe politikave të privatësisë të ofruesve përkatës palë e tretë (të cilat janë të pavarura nga këto Kushte). Sipas rastit, do t'ju duhet t'i lexoni dhe t'i pranoni ato për të aksesuar dhe përdorur përmbajtjet dhe shërbimet e palëve të treta. Për shembull, për të përdorur veçoritë e mediave sociale, do t'ju duhet të keni një llogari me ofruesin përkatës të mediave sociale dhe do t'ju duhet të pranoni kushtet dhe politikat e tyre të privatësisë.
- 5.3 Ne nuk jemi përgjegjës për asnjë marrëveshje të lidhur midis jush dhe ofruesve të përmbajtjeve dhe shërbimeve të palëve të treta, pasi ato janë nën përgjegjësinë tuaj. Për shembull, ju jeni përgjegjës për pagesën e tarifave për aplikacionet e palëve të treta që zgjidhni të shkarkoni ose të abonoheni.
- 5.4 Zgjedhja e përmbajtjeve dhe shërbimeve të palëve të treta të disponueshme për automjetin tuaj mund të jetë subjekt i ndryshimeve të herëpashershme. Ne kemi të drejtë të ndryshojmë, pezullojmë, heqim ose çaktivizojmë aksesin në përmbajtjet dhe shërbimet e palëve të treta në çdo kohë pa paralajmërim.
- 5.5 Herë pas here, ne mund të ofrojmë përditësime për përmbajtjet dhe shërbimet e palëve të treta, për të cilat mund t'ju kërkohet të pranoni kushtet e përgjithshme të reja ose të përditësuara dhe politikat e privatësisë së palës së tretë.

## **6. Përdorimi i veçorive**

- 6.1 Veçoritë ofrohen vetëm për përdorim të brendshëm privat ose përdorim të brendshëm nga biznesi juaj në lidhje me automjetin. Veçoritë duhet të përdoren vetëm për qëllimin e synuar dhe jo për rishitje. Ju nuk duhet të lejoni askënd tjetër të përdorë Veçoritë në mënyra që:

- (a) janë të paligjshme, të ndaluara ose të kufizuara në vendin në të cilin keni ndërmend të përdorni ose po përdorni Veçoritë (për shembull në vende ku nuk lejohet përdorimi i informacionit të vendndodhjes së kamerës së sigurisë);
  - (b) janë të rrezikshme ose që vënë në rrezik sigurinë tuaj, të pasagjerëve tuaj ose të ndonjë personi tjetër;
  - (c) dëmtojnë automjetin, të dhënat, softuerin, pajisjen, sistemet kompjuterike apo rrjetet;
  - (d) nuk janë të autorizuara nga ne ose që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale (duke përfshirë të drejtat e ofruesve palë e tretë).
- 6.2 Krahas kushteve në klauzolën 6.1, ju nuk duhet të përdorni shfletuesin e internetit të InControl Touch Pro:
- (a) në mënyra që mund të dëmtojnë, çaktivizojnë, mbingarkojnë, çrregullojnë ose cenojnë sistemet ose sigurinë tonë ose të ofruesit të rrjetit ose të ndërhyjnë me përdoruesit e tjerë të rrjetit; ose
  - (b) për shpërndarje "peer to peer" ("P2P") të skedarëve, përdorim të protokollit "bit torrent", ose rrjetit të serverëve përfaqësues, dërgimin masiv të emailëve të padëshiruara ose mesazhe tregtare, ruajtjen e çdo forme të serverit të emailit, ose në çfarëdolloj mënyre që përfshin ofrimin e ndonjë shërbimi që lejon aksesin në një adresë interneti ose adresë IP-je publike.
- 6.3 Ju jeni përgjegjës për respektimin e të gjitha rregullave në fuqi të qarkullimit rrugor dhe praktikave të mira të drejtimit të automjetit në lidhje me përdorimin e Veçorive nga ana juaj.
- 6.4 Ne përpiqemi të sigurojmë disponueshmëri dhe funksionim të duhur të Veçorive, por nuk mund të garantojmë që Veçoritë (ose funksionet e tyre) nuk do të kenë gabime, që do të jenë vazhdimisht të disponueshme, ose që do të lejohen të përdoren sipas ligjeve vendore në të gjitha shtetet. Për shembull, gjatë përdorimit të shfletuesit të internetit të InControl Touch Pro, disa faqe interneti mund të mos shfaqen ose të mos funksionojnë siç duhet në ekranin e automjetit.
- 6.5 Disponueshmëria dhe funksionimi i disa aspekteve të Veçorive varen nga mbulimi i rrjetit celular dhe faktorë të tjerë që janë jashtë kontrollit tonë. Për shembull, lidhja e rrjetit mund të jetë e padisponueshme në zona të largëta ose të izoluara, dhe mund të ndikohet nga pengesa si p.sh. kodra, ndërtesa të larta, tunele ose nga kapaciteti i rrjetit. Përveç kësaj, Veçoritë mund të jenë subjekt i ndërprerjeve të herëpashershme për shkak të mirëmbajtjes ose modifikimeve të rëndësishme, por ne do të përpiqemi gjithmonë të minimizojmë çdo mungesë shërbimi të shkaktuar nga këto ndërprerje.
- 6.6 Ne nuk mund të garantojmë që të dhënat ose përmbajtjet e navigimit (p.sh. hartat, kamerat e sigurisë, kufijtë e shpejtësisë ose të dhënat e trafikut) janë të sakta, të plota

ose të përditësuar. Këto ofrohen për t'ju lehtësuar punë, por ju mbeteni përgjegjës për respektimin e rregullave të trafikut, duke përfshirë sinjalistikën rrugore dhe kufijtë e shpejtësisë.

- 6.7 Ne rezervojmë të drejtën për të ndryshuar, pezulluar, hequr ose çaktivizuar aksesin te Veçoritë ose funksionet në çdo kohë pa lajmërim. Për shembull, kjo gjë mund të jetë e nevojshme për të kryer mirëmbajtjen e rëndësishme në sistemet që operojnë Veçoritë, për arsye sigurie, nëse kërkohet me ligj, ose nëse ne nuk ofrojmë më disa Veçori ose funksione të veçanta në vendin tuaj ose për klientët tanë në përgjithësi.
- 6.8 Është përgjegjësia juaj të fshini të gjitha informacionet personale, përmbajtjet dhe të dhënat e tjera që mund të kenë ruajtur në automjet, në masën e lejuar nga Veçoritë dhe pajisjet e automjetit, përpara se të transferoni pronësinë e automjetit ose të ktheni automjetin e marrë me qira tek pronari kryesor i automjetit. Për shembull, ju mund të fshini preferencat tuaja, historikun e shfletimit dhe çdo kuki të ruajtur nga shfletuesi i internetit i InControl Touch Pro duke përdorur cilësimet e shfletuesit të internetit.
- 6.9 Ju jeni përgjegjës për përdorimin e funksionit "më mbaj mend" që aplikohet në disa Veçori. Ky funksion ju mundëson të mbeteni automatikisht të identifikuar në automjet për të aksesuar më lehtë Veçoritë. Kini parasysh që gjatë kohës që ky funksion është aktiv, personat e tjerë që përdorin automjetin do të mund të shikojnë cilësimet, veçoritë dhe të dhënat personale të ruajtura në automjet dhe të përdorin veçoritë në vendin tuaj. Ju duhet të siguroheni që funksioni "më mbaj mend" të jetë i çaktivizuar nëse nuk dëshironi që përdoruesit e tjerë të kenë akses në të. Në momentin që ju nuk jeni më pronar i automjetit ose nuk e përdorni më atë (për shembull, nëse e shisni automjetin, nëse ju ka përfunduar afati i qirasë ose në rast humbjeje apo vjedhjeje të automjetit) ju duhet të siguroheni që funksioni "më mbaj mend" për disa Veçori të caktuara, të jetë çaktivizuar dhe/ose ju të jeni çidentifikuar nga Veçoritë.
- 6.10 Ne nuk jemi përgjegjës për faqet e internetit, përmbajtjet ose të dhënat e palëve të treta që zgjidhni të përdorni në internet duke përdorur shfletuesin e internetit të InControl Touch Pro, prandaj çdo përdorim i tillë është në përgjegjësinë tuaj. Këto faqe interneti përdorin kuki ose pajisje të ngjashme. Ju këshillojmë të lexoni dhe të siguroheni që jeni të kënaqur me kushtet e përgjithshme, politikat e privatësisë dhe politikat e kukive për faqet e internetit të palëve të treta që vizitoni.
- 6.11 Përdorimi i disa Veçorive të caktuara (për shembull, shfletuesi i internetit i InControl Touch Pro) mund të jetë i kufizuar gjatë kohës që automjeti është në lëvizje.
- 6.12 Për InControl Touch Pro, lidhja me Wi-Fi Hotspot nuk do të jetë e disponueshme gjatë kohës që janë të aktivizuar shërbimet "Thirrja e emergjencës SOS" dhe "Asistenca e optimizuar në rrugë". Lidhja me Wi-Fi Hotspot mund të mos jetë gjithashtu e disponueshme për tridhjetë minuta që nga përfundimi i thirrjes së emergjencës SOS dhe thirrjes për asistencë të optimizuar.

## **7. Përdorimi i të dhënave dhe privatësia**

7.1 Ne do t'i përdorim të dhënat personale në përputhje me kushtet e Politikës së Privatësisë së InControl, e cila është e disponueshme në faqen e mëposhtme të internetit:

- <https://incontrol.jaguar.com/jaguar-portal-owner-web/about/privacy-policy/ALB>
- <https://incontrol.landrover.com/jlr-portal-owner-web/about/privacy-policy/ALB>

## **8. Kufizimi i përgjegjësisë**

8.1 Nëse jeni klient, keni të drejta ligjore në lidhje me shërbimet që nuk kryhen në nivelin e duhur të cilësisë dhe kujdesit, ose lidhur me softuerët që janë me defekt ose që nuk janë siç përshkruhen. Mund të merrni këshillim për të drejtat tuaja ligjore nga Zyra juaj vendore e Këshillimit për Qytetarët ose zyra e Standardeve Tregtare. Asnjë pjesë e këtyre Kushteve nuk do të ndikojë mbi këto të drejta ligjore.

8.2 Asnjë pjesë e këtyre Kushteve nuk do të kufizojë apo të përjashtojë përgjegjësinë tonë për vdekje ose lëndime personale të shkaktuara nga neglizhenca jonë, mashtrime ose pretendime të rreme, ose çdo përgjegjësi tjetër që nuk mund të përjashtohet apo të kufizohet nga legjislacioni anglez.

8.3 Përveç rasteve të shprehura në klauzolën 8.2 ose siç parashikohet ndryshe sipas kushteve të një garancie të vlefshme të prodhuesit për automjetin, përgjegjësia jonë maksimale ndaj jush sipas dhe në lidhje me këto Kushte dhe Veçori (qoftë bazuar në kontratë, pretendim në bazë dëmi - duke përfshirë midis të tjerash nga pakujdesia - për mospërmbushje të detyrimeve e të tjera) do të kufizohet në një shumë të barabartë me tarifën e paguara nga ju për ne për Veçoritë.

8.4 Përveç rasteve të shprehura në klauzolën 8.2 ose siç parashikohet ndryshe sipas kushteve të garancisë së vlefshme të prodhuesit për automjetin, ne nuk do të jemi në asnjë rrethanë përgjegjës për:

- (a) humbje ose dëme të paparashikuara. Humbjet ose dëmet janë të parashikueshme nëse vijnë si pasojë e shkeljeve të dukshme nga ana jonë ose nëse janë të parashikuara nga ju dhe ne në kohën kur keni blerë automjetin ose paketën e opsioneve ku përfshiheshin Veçoritë;
- (b) çdo humbje të biznesit që rrjedh nga këto Kushte ose në lidhje me Veçoritë (duke përfshirë, ndër të tjera, humbjen e fitimit ose të ardhurave, humbjen e biznesit, ndërprerjen e biznesit ose humbjen e mundësive të biznesit); ose
- (c) humbje të tërthorta ose shkakësore.

8.5 Këto Kushte përcaktojnë shtrirjen e plotë të detyrimeve dhe përgjegjësisive tona në lidhje me ofrimin e Veçorive. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht në këto Kushte, nuk ka kushte, garanci, deklarime ose kushte të tjera, të shprehura ose të



nënkuptuara, që janë të detyrueshme për ne. Çdo kusht, garanci, deklaram ose kusht tjetër në lidhje me ofrimin e Veçorive, që përndryshe mund të nënkuptohet ose të përfshihet në këto Kushte, qoftë me statut, të drejtë zakonore ose të tjera, përjashtohet në masën më të plotë të lejuar nga ligji.

- 8.6 Ne nuk do të jemi përgjegjës për pamundësinë e ofrimit të Veçorive ose ndonjë efekt negativ në përdorimin e Veçorive, që është shkaktuar nga një veprim ose ngjarje jashtë kontrollit tonë të arsyeshëm, duke përfshirë, ndër të tjera, defektet ose ndërprerjen e rrjeteve të telekomunikacionit publik ose privat ose të internetit.

## **9. Ndërprerja ose pezullimi**

- 9.1 Ju mund të zgjidhni të ndërpritni përdorimin e Veçorive në çdo moment, megjithatë, në varësi të specifikave të automjetit, disa përditësime të softuerit mund të mbeten aktive. Për të çaktivizuar lidhjen e të dhënave celulare për planin tuaj të të dhënave, përdorni cilësimet e Lidhjes së automjetit.

- 9.2 Nëse nuk respektoni këto Kushte, ne mund të mbyllim ose pezullojmë menjëherë llogaritë, abonimet dhe/ose aksesin tuaj në funksionimin e Veçorive pa njoftim paraprak.

## **10. Kushte të tjera të rëndësishme**

- 10.1 Ne mund të bëjmë ndryshime në Veçori dhe/ose këto Kushte herë pas here si rezultat i: një ndryshimi në ofruesit tanë të Veçorive, në shërbimet e tyre ose kushtet e tyre të përgjithshme; një ndryshimi rregullator ose një ndryshimi në ligj; përmirësimeve ose modifikimeve të Veçorive; dhe/ose ndryshimeve në praktikën tonë të privatësisë dhe përdorimit e të dhënave në lidhje me Veçoritë. Ne gjithmonë do të përpiqemi të sigurojmë që çdo ndryshim të mos përbëjë disavantazh madhor për ju. Në varësi të ndryshimit, mund të mos jeni në gjendje të përdorni Veçoritë përkatëse derisa të keni instaluar një përditësim të softuerit dhe/ose të keni pranuar çdo kusht të përgjithshëm që mund të zbatohet.

- 10.2 Nëse do të na duhet t'ju kontaktojmë, do të përdorim të dhënat e kontaktit që keni dhënë në llogari, ose nëse nuk keni llogari, të dhënat e kontaktit që i keni dhënë shitësit të autorizuar nga i cili keni blerë automjetin.

- 10.3 Ju nuk do të përfitoni në statusin e palës së tretë nga asnjë marrëveshje midis nesh dhe ofruesve të Veçorive.

- 10.4 Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të Veçorive janë në pronësi ose të licencuara për ne ose për ofruesit tanë të veçorive. Të drejtat për të përdorur Veçoritë janë të licencuara (nuk shiten) për ju, dhe ju nuk keni të drejta në ose ndaj tyre, përveç rasteve në përputhje me këto Kushte.

- 10.5 Ju mund t'i transferoni të drejtat ose detyrimet tuaja sipas këtyre Kushteve te një person tjetër vetëm nëse biem dakord me shkrim. Ne mund të transferojmë të drejtat dhe detyrimet tona sipas këtyre Kushteve, por kjo nuk do të ndikojë në të drejtat tuaja sipas këtyre Kushteve.
- 10.6 Këto Kushte do të vazhdojnë të zbatohen për aq kohë sa ju përdorni veçoritë.
- 10.7 Secila prej klauzolave në këto Kushte funksionon në mënyrë të pavarur. Nëse gjykata ose autoriteti përkatës vendos që ndonjë prej klauzolave është e paligjshme ose e pazbatueshme, klauzolat e mbetura do të mbeten në fuqi dhe në efekt të plotë.
- 10.8 Nëse ne nuk këmbëngulim që ju të përmbushni detyrimet tuaja sipas këtyre Kushteve, ose nëse ne nuk zbatojmë të drejtat tona kundrejt jush ose nëse vonojmë ta bëjmë këtë gjë, kjo nuk do të thotë se ne kemi hequr dorë nga të drejtat tona kundrejt jush dhe nuk do të thotë që ju mund t'i shkelni ato detyrime. Nëse heqim dorë nga shkeljet e këtyre Kushteve nga ana juaj, ne do ta bëjmë këtë gjë vetëm me shkrim dhe kjo nuk do të thotë se ne do të heqim dorë automatikisht nga çdo shkelje e mëvonshme nga ana juaj.
- 10.9 Nëse jeni klient, kini parasysh se kjo kontratë ndërmjet jush dhe nesh rregullohet nga legjislacioni anglez. Kjo do të thotë se çdo mosmarrëveshje ose pretendim që lind nga ose në lidhje me këto Kushte do të rregullohet nga legjislacioni anglez. Të dyja palët biem dakord që gjykatat e Anglisë dhe Uellsit do të kenë juridiksion joekskluziv. Zgjedhja e mësipërme e legjislacionit nuk cenon dispozitat e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit që zbatohen në Shqipëri.
- 10.10 Nëse jeni biznes, këto Kushte të përgjithshme, lënda dhe përpilimi i tyre (dhe çdo mosmarrëveshje ose pretendim jokontraktual) rregullohen nga legjislacioni anglez. Të dyja palët pajtohem me juridiksionin ekskluziv të gjykatave të Anglisë dhe Uellsit.